



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 3122 / Prot
2

Tiranë, më 04/10 /2022

Lënda: Njoftim për vend të lirë

DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

KËTU

SHKOLLËS SË MESME PROFESIONALE “TREGTARE”

VLORË

Mbështetur në Ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në republikën e Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.554 datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 14, datë 27.5.2021 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësive të zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit shkresën nr.1838 prot., datë 29.01.2020 “Organika e Shkollës së Mesme Profesionale “Tregtare” Vlorë”, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë ju njoftojmë shpalljen për vend të lirë pune të pozicionit, si më poshtë:

Pozicioni i punës:

- Drejtor i Shkollës së Mesme Profesionale “Tregtare”, Vlorë

Kandidati aplikues për pozicionin e punës: Drejtor i Shkollës së Mesme Profesionale “Tregtare”, Vlorë, duhet të përmbushë kriteret si më poshtë:

1. Kriteret të përgjithshme:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;

d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar.

2. Kriteria të posaçme:

- a) të ketë diplomë të studimeve universitare master i shkencave (ose të barasvlershëm me të), në një nga profesionet që lidhet me fushat e kualifikimeve profesionale të ofruesit të AFP-së;
- b) të ketë jo më pak 5 (pesë) vjet përvojë pune në menaxhim, në sistemin e AFP-së ose fusha profesionale, në përputhje me kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së;
- c) të ketë njohuri të certifikuara të përdorimit të teknologjisë së informacionit;
- d) preferohet të ketë njohuri të gjuhës angleze dhe/ose të gjuhëve të huaja të tjera.

3. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) letërmotivimin për pozicionin;
- b) jetëshkrimin (CV-në), i cili plotësohet sipas formatit në shtojcën 11 të Udhëzimit nr.14 të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë;
- c) kartën e identitetit
- d) diplomën
- e) librezën e punës
- f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në jetëshkrim;
- g) certifikatë/a ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- i) vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- j) vërtetim nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
- k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.

Dokumentat në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuara.

Afati i njoftimit fillon më datë 05.10.2022.

Njoftimi bëhet në faqen zyrtare të AKPA-së, në faqen elektronike zyrtare të Shkollës së Mesme Profesionale “Tregtare”, Vlorë (nëse ka), si dhe në një vend të dukshëm në hyrje të Shkollës së Mesme Profesionale “Tregtare”, Vlorë.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të Drejtorisë Qendrore të AKPA-së, brenda datës 14.10.2022.

Struktura e vlerësimit të kandidatëve fitues në fazën e dytë është si më poshtë:

- Vlerësimi për dokumentacionin e dorëzuar është 40 pikë;
- Vlerësimi për kriteret e tjera nëpërmjet intervistës me gojë është 60 pikë.

Në intervistë, ndër të tjerat, kandidati vlerësohet për:

- i. njohuritë e përgjithshme mbi legjislacionin, mbi të cilin rregullohet dhe organizohet veprimtaria e ofruesit të AFP-së.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

- Ligji nr. 15/2017, datë 16.2.2017 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
 - Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.554, datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”;
- ii. prespektivën e tij për zhvillimin dhe mirëadministrimin e Shkollës së Mesme Profesionale “Tregtare”, Vlorë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Klevis HYSA